“Atë që ia kërkon Allahut me sinqeritet gradën e shehidit, Allahu ka për ta ngritur në pozitën e shehidëve, edhe nëse vdes në shtratin e tij.”

Sehël ibn Hunejfi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton nga Profeti ﷺ se ka thënë: “Atë që ia kërkon Allahut me sinqeritet gradën e shehidit, Allahu ka për ta ngritur në pozitën e shehidëve, edhe nëse vdes në shtratin e tij.”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se atij që e kërkon shehidllëkun e që të vritet në rrugën e Allahut dhe është i sinqertë dhe i çiltër në qëllimin e tij për hir të Allahut të Lartmadhëruar, Ai do t'ia japë gradat e shehidëve për shkak të qëllimit të tij të sinqertë, edhe nëse ai vdes në shtrat në një gjendje tjetër përveç xhihadit.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3157